

VEPNDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 DËLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROŠEVAC

28.05.2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin Ibrahim Idrizi dhe zyrtare ligjore Albana Ajvazi, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale “Lëndim i lehtë trupor” nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 pika 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II. nr. 128-1/2017 të datës 08.02.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik me datë 20.02.2018, në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Valdet Avdiu dhe të pandehurit [REDAKTUAR] dhe mbrojtësit të tij me autorizim av. [REDAKTUAR] të njëjtën datë mori dhe komunikoi kurse me dt. 26.02.2018 përpiloi me shkrim këtë:

AKT GJYKIM

I pandehuri [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR] i lindur më [REDAKTUAR] në Ferizaj, me numër personal [REDAKTUAR] me vendbanim në rr. [REDAKTUAR], nr. [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, ka të kryer fakultetin Inxhinieri Komjuterike, me profesion autoelectricist, pronar i autoservisit “[REDAKTUAR]”, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, prind i një fëmije, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 19.01.2017, rreth orës 10:10, në rrugën “Bajram Sylejmani”, në Ferizaj, të autoservisit [REDAKTUAR], pronë e të pandehurit [REDAKTUAR], i njëjti me dashje që ti shkaktoj lëndime trupore të dëmtuarit [REDAKTUAR], pas një fjalosje të atëçastshme ndërmjet të pandehurit dhe të dëmtuarit, i dëmtuari kishte shkuar te servisi i të pandehurit për t’ia dhenë një borxh prej 50€, por, për një moment kishte filluar një fjalosje verbale mes tyre, rreth bashkëpunimit lidhur me punët e tyre, si automekanik, i njëjti e ka sulmuar fizikisht të dëmtuarin, në atë mënyrë që e ka goditur me një mjet të fortë-lopatë, mjet i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve trupore, me ç’rast të dëmtuarit i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore, në formë plage shqyese, ndrydhëse në regjionin muror të kokës, me pasoja të përkohshme për shëndetin.

- me të cilën ka kryer veprën penale "Lëndim i lehtë trupor" nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 të KPK-së

Andaj Gjykata në bazë nenit 188 par. 2 lidhur me par. 1 dhe neneve 7, 8, 9, 10, 17, 21, 41, 43, 45, 46, 47, 73, 74, 75, 76 të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPPK-ës, e

G J Y K O N

ME DËNIM BURGIMI PREJ 4/KATËR /MUAJ i cili dënim në bazë të nenit 47 të KPK-së iu zëvendësohet në dëmin ME GJOBË NË SHUMËN PREJ 800/TETËQIND/€, të cilën shumë është i obliguar që të paguaj në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimit të merr formën e prerë.

Nëse dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPK-ës do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 Euro do të vuaj nga një ditë burgimi.

I dëmtuari [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20/njëzetë/€, shumën prej 30/tridhjetë/€ për fondin për Kompenzimin e Viktimave të Dhunës, të cilat obligohet që ti paguaj në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

1. Historiku procedural

Prokuroria e Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/I.nr. 128-1/2017, të datës 08.02.2017, ka akuzuar [REDAKTUAR], për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 pika 1.4 të KPRK-së.

Gjyqtari duke vepruar sipas kësaj akuze ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 20.02.2018, në të cilën i pandehuri është deklaruar fajtor për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Deklarimi i të pandehurit është vlerësuar se i plotëson kushtet nga neni 248 par. 1 të KPPK-së pasi që i pandehuri ka kuptuar:

- natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë;
- pranimi është bërë vullnetarisht dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av. [REDAKTUAR];
- mbështetet në faktet dhe në provat e çështjes si: konstatimi dhe mendimi i ekspertit mjeko – ligjor i dt. 05.02.2017 lidhur me llojin dhe natyrën e lëndimeve për të dëmtuarin [REDAKTUAR];
- se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, andaj gjyqtari konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

3. Analiza e Ligjit Material

Gjyqtari vlerësoi se në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha tiparet subjektive dhe objektive të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 pika .14 të KPK-së, meqë i akuzuari me dashje direkte në vend, datë dhe kohë e përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ka goditur të dëmtuarin me një mjet të fortë – lopatë, mjet i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve trupore, me ç'rast tek i dëmtuari ka shkaktuar lëndime të lehta trupore në formë plagë shqyese, ndrydhëse në regionin muror të kokës, me pasoja të përkohshme për shëndetin.

4. Vlerësimi i dënimit të shqiptuar

Gjykata me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK-së.

Si rrethanë veçanërisht lehtësuese mori, pranimin e fajësisë që në seancën fillestare si dhe rrethanën se i akuzuari me të dëmtuarin kanë relaksuar raportet e tyre dhe tani ata prap vazhdojnë të ketë raporte bashkëpunimi, kurse këto rrethana i ndërlidhi me rrethanat

lehtësuese përkatësisht rrethanat personale se i akuzuari është i martuar babë i një fëmijëve, ndërsa nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me dënimin e shqiptuar është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPK-ës, se edhe me anë të këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit, parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale. Andaj Gjykata vlerëson se edhe me aplikimin e nenit 75 par. 1 pika 1.3 të KPPK-së mund të arrihet qëllimi i dënimit.

4. Shpenzimet procedurale

Konform nenit 463 të KPPK-së pala e dëmtuar udhëzohet në kontest civil.

Gjykata konform nenit 450 par.2 pika 6 të KPPK-së, i caktoi shpenzimet paushalle në lartësi prej 50/pesëdhjetë/€, bazuar në komplikueshmërinë e kësaj çështje, i cili obligohet që ti paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, prej ditës kur aktgjykimi merr formën e prerë.

Nga arsyet e lartpërmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr. 352/17, më 26 shkurt 2018.

**Zyrtare ligjore,
Albana Ajvazi**

**Gjyqtari,
Ibrahim IDRIZI**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 dite, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.